REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

ADMINISTRATORI

Nr. 2570/1 Prot

Shkodër, më 24.02.2025

Lënda: Dërgohen për botim në Buletinin e APP-së 2 vende vakante

Agjencisë së Prokurimit Publik

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë

Përshëndetje,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet e shpalljes së konkursit për pozicionet e mëposhtme në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi":

1 Specialist ekonomist në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit

Dhe

1 Përgjegjës I Sektorit të Prokurimeve në Drejtorinë e Fondit të Investimeve dhe Shërbimeve

Lutemi botojeni në Buletinin tuaj!

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Administratori

Admir Uruçi

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, +355(22)800651, http://www.unishk.edu.al, info@unishk.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

ADMINISTRATORI

Nr. 2570 Prot Shkodër, më 24.02.2025

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shpallet konkursi për 2 vende vakante, kategoria staf administrativ, përkatësisht:

SPECIALIST EKONOMIST
në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit

I. Kritere të përgjithshme:

Kandidatët për pozicionin Specialist-Ekonomist duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme:**

a. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
b. Të zotërojnë aftësistë profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
c. Të kenë aftësitë e punës në grup dhe të komunikimit profesional;
d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
e. Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;
f. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
g. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
h. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.

II. Kriteret specifike:

Kandidatët për pozicionin, Specialist/ Ekonomist, duhet të plotësojnë këto **kritere specifike**:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushat përkatëse, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose program studimi 4- vjeçar*) me notë mesatare jo më të ulët se 6.5
   Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse.
2. Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" dhe "Master i Shkencave", (në të njëjtën fushë), në: ***Shkenca EKONOMIKE***
3. Të njohë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), me nivel jo më të ulët se C1, të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
4. Të ketë jo më pak se 3 vitet e fundit eksperiencë pune si ekonomist/e në administratën publike;ne institucionet e arsimit te larte
5. Preferohet që kandidatët:
   - të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
   - të kenë aftësi të mira kompjuterike;

III. Dokumentacioni:

Kandidatët për pozicionin Ekonomist, duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", dokumentet si më poshtë:

a. Kërkesë me shkrim për punësim në USH.
b. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
c. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSC; sistemi 4-vjeçar; ose DIND) në fushat e lartpërmendura dhe listën përkatëse të notave, të noterizuara. *Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.*
d. Rekomandim ose leter referencë nga punëdhënësi i fundit.
e. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore, ose kopje e noterizuar.
f. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
g. Dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim gjykate dhe vërtetim nga prokuroria;
h. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë
i. Vërtetim nga qëndra e punës në të cilen ka punuar ose punon (kopje e noterizuar e librezës së punës) dhe/ose çdo dokumentacion tjetër ligjor, që provon eksperiencën në punë.

j. deklaratë personale që dëshmon për moslidhje familjare, (neni 5, pika 3/c) dhe që kandidati nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).

k. Fotokopje e pasaportës ose kartës ID.

Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve jurist/ekonomist

IV. Kritere të përgjithshme:

Kandidatët për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme:**

- Kandidatet për pozicionet e lira të nivelit drejtues, duhet të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose program studimi 4-vjeçar*) me notë mesatare jo më të ulët se 7.5 në shkenca juridike/shkenca ekonomike.
- Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet çertifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të njohë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, me nivel jo më të ulët se B1 (notë jo më të ulët se 7), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.

Preferohet që kandidatët:

- Të kenë kryer specializime apo kualifikime në fushën përkatëse ku konkuron.
- (Të jenë certifikuar nga ASPA në mbështetje të nenit 23 të Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për prokurimin Publik", si dhe të nenit 75/1 pika 14 të V.K.M nr.285, dt.19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik")
- Të kenë eksperiencë pune të ngjashme;
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
- Të kenë aftësi të mira kompjuterike;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë aftësistë profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- Të kenë aftësitë e punës në grup dhe të komunikimit profesional;
- Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
- Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;
- Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

- Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.
- Të ketë jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në fushën e prokurimit në administratën publike;

V. Dokumentacioni:

Kandidati duhet të dorëzojë me postë drejtuar Universitetit te Shkodrës "Luigj Gurakuqi", dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim për punësim në USH;
- curriculum vitae;
- diplomën dhe çertifikatën e notave të studimeve në specialitetin ku është shpallur konkursi të noterizuara. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet çertifikata e njohjes nga Ministria përgjegjëse, të noterizuara.
- dëshmi të kualifikimeve të niveleve të ndryshme pasuniversitare. Për dëshmitë e marra në universitetet e huaja duhet të dorëzohet çertifikata e njohjes nga Ministria përgjegjëse, e noterizuar.
- dëshminë e zotërimit të gjuhës së huaj, të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore;
- referencë e qendrës së mëparshme të punës;
- raport mjeko-ligjor për aftësi në punë;
- dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata dhe prokuroria;
- deklaratë personale që dëshmon për moslidhje familjare, (neni 5, pika 3/c) dhe që kandidati nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
-Fotokopje e pasaportës ose kartës ID.

Administratori

Admir Uruçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR